



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2022:268573

Datë: 08.12.2023

Numri i dokumentit: 05037206

**C-IV-14-4034**

*Ankuesi*

**F B**, fshati O, Vushtrri

**Kundër**

*E paditura*

**Agjencia Kosovare e Privatizimit**, , rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

**Për: Palët**

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Sylejman Shumolli, me 1 dhjetor 2023 lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

- 1. APROVOHET** ankesa si e bazuar dhe **ndryshohet** vendimi i Autoritetit të Likuidimit të AKP-së nr. MIT042-0585 datë 14 prill 2014.
- 2. OBLIGOHET** e paditura AKP, që ankuesit **F B**, në emër të kompensimit të pagave të papaguara për periudhën 1992 – 1999, përveç shumave të pranuar me vendimin e kundërshtuar, t’i paguaj edhe shumën e refuzuar përkatësisht **shumën prej 6,255.00 €** dhe në emër të interesit ligjor prej 10 % të shumës themelore të refuzuar, t’i paguaj **shumën prej 625.50 €**.
- 3.** Shumat e aprovuara si në pikën 2 të dispozitivit do të përmbushen në pajtim të prioritetit sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave në procedurën e likuidimit.

**Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me 15 maj 2014, ankuesi dorëzoi në Dhomën e Posaçme, një ankesë kundër Vendimit me nr. MIT042-0585, të datës 14 prill 2014, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej: Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), më të cilin kërkesa e tij për kompensim për paga të papaguara në shumë prej 10,146.00 € për periudhën 1992 – 1999, i ishte pranuar kompensimi i pagave të pa paguara në shumën prej 3,696.12 € në pajtim me pikat e nenit 40.1.7 të Shtojcës së ligjit 04/L-034 për AKP-në dhe shumën prej 389.76 €, në pajtueshmëri me

nenin 38.1 të ligjit nr.38.1 të ligjit nr.03-L-161 “Për tatimin në të ardhurat personale” dhe paragrafit nr. 2a dhe 2b të nenit nr.6 i ligjit nr.04/L-101 “Për Fondin Pensional të Kosovës” dhe i ishte refuzuar kompensimi në shumën prej 6,255.00 €, për arsye se kjo shumë do të zbritet si borxh për qira të papaguar të dyqanit “Z”, aseti i NSH “Çyçavica” (në likuidim) për periudhën nga 2003 deri dhjetor 2013. Ankuesi pohon së më këtë vendim AKP-ja nuk i ka vlerësuar drejt provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës me çka ka rezultuar në shkelje të ligjit të DHPGJS dhe vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, andaj me anë të ankesës propozon që të i aprovohet ankesa si e bazuar duke e ndryshuar vendimin e AKP-së duke i’u njohur të drejtën në kamatën 4.5 % sipas aktvendimit të Gjykatës Komunale në Vushtrri E. nr. 820/2006 datë 05 tetor 2006, për periudhën kohore nga viti 1992 deri në 1999. Gjithashtu, ankuesi kërkon që edhe kamata e cila është caktuar sipas vendimit të gjykatës ti llogaritet në shumën në të cilën NSH “Çyçavica” i ka mbetur borxh, e jo siç ka vepruar AKP-ja. Në mbështetje të kësaj ankese ankuesi ka bashkangjitur dëshmitë në kopje si: Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Vushtrri me nr.820/06 të datës 05 tetor 2006 dhe vendimin e kundërshtuar.

Me 18 gusht 2023, e paditura AKP-ja parashtrroi mbrojtjen e saj, në të cilën konstatoi se kërkesa është parashtruar më 16 tetor 2013, që është brenda afatit për parashtrimin e kërkesave. Ashtu që duke u bazuar në nenin 40.1.6.1 i cili parasheh që parashtruesve u takon e drejta për kompensimin e pagave të papaguara nëse *“pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguar deri në datën e vendimit nga Gjykata apo Agjencia për fillimin e procedurave të likuidimit”*. Në pajtim me nenin 38.1 të ligjit nr.03-L-161 *“Mbi tatimin në të hyrat personale secili punëdhënës do të jetë përgjegjës për ndalesën e tatimi nga rrogat e tatueshme të paguara ndaj punëtoreve gjatë çdo periudhe të rrogave për të cilën paguhen rrogat”*. Sipas paragrafit nr. 2a dhe 2 b të nenit 6 i ligjit nr.04/L-101, punëdhënësi do të paguaj një shumë të barabartë me 5% të rrogave të përgjithshme të të gjithë punonjësve të saj, dhe çdo punonjës paguan një shumë të barabartë në 5% të pagave në total të tij/saj. Prandaj, për arsyet e lartcekura e paditura vendosi që të pranoj shumën prej 1,844.04 euro në përputhje me dispozitat e nenit 40.1.7 të Shtojcës së Ligjit 04/L-03 për AKP-në, dhe të pranoj shumën prej 193.92 euro në përputhje me dispozitat e nenit 38.1 të ligjit nr.03/L-161 për Tatimin në të Ardhura Personale dhe sipas paragrafit nr. 2a dhe 2b të Ligjit nr.04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, shuma e cila është e pagueshme tek ATK për dhe në emër të parashtruesit të kërkesës. E paditura propozoi që ankesa të refuzohet si e pabazuar dhe të vërtetohet vendimi i AL-së në pajtim me nenin 74.4 të Ligjit nr.06/L-086. Në mbështetje të mbrojtjes së saj, AKP-ja ka bashkëngjitur në kopje një Vendim\* të korigjuar, datë 25 shkurt 2015 dhe një kopje mbi informatat e llogarisë bankare.

Për detaje tjera referimi mund të bëhet tek dosja e lëndës.

### **Arsyetimi ligjor:**

Ankesa aprovohet si e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrirat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Nga ankesa e ankuesit dhe shkresat tjera të lëndës, del që ankuesi ka kundërshtuar vendimin e AL nr. MIT042-0585, datë 14 prill 2014, me të cilin vendim kërkesa e tij për kompensim për paga të papaguara në shumë prej 10,146.00 € për periudhën 1992 – 1999, i ishte pranuar pjesërisht ashtu që i ishte njohur kompensimi i pagave të pa paguara në shumën prej 3,696.12 € dhe në shumën prej 389.76 € dhe i ishte refuzuar kompensimi në shumën prej 6,255.00 €. E paditura në mbrojtjen e saj ka bashkëngjitur një vendim\* të korrigjuar me të cilin vendim, kërkesa e tij për kompensim për paga të papaguara në shumë prej 10,146.00 € për periudhën 1992 – 1999, i ishte njohur kompensimi i pagave të pa paguara në shumën prej 1,844.04 € dhe në shumën prej 193.92 € dhe i ishte refuzuar kompensimi në shumën prej 8,205.00 € (vendim me të cilin lartësia e kompensimit të pranuar me vendimin e kundërshtuar të ankuesit i ishte përgjysmuar). Gjykata konstaton se objekt shqyrtimi i ankesës është vetëm vendimi i kundërshtuar dhe pretendimet tjera (përfshirë vendimin\* e korrigjuar të dorëzuar nga e paditura) përtej kërkesës së ankuesit për kompensim të pagave të papaguara, janë jashtë kufijve të shqyrtimit të ankesës në lidhje me vendimin e kundërshtuar të ankuesit dhe si të tilla nuk do të merren në shqyrtim. Për më tepër, çfarëdo korrigjimi që mund të bëhet në një lëndë rast apo procedurë, ka të bëjë vetëm me përmirësimin e gabimeve teknike, mirëpo jo edhe me ndryshimin e lartësisë së kompensimit tanimë të miratuar pjesërisht me vendimin e kundërshtuar objekt i shqyrtimit të kësaj ankesë. Prandaj vendimi\* i korrigjuar i datës 25 shkurt 2015, është pa efekt ligjor në lidhje me reduktimin e shumës së aprovuar të kërkesës së ankuesit për kompensim të pagave të papaguara të aprovuar pjesërisht me vendimin e kundërshtuar.

Nga pohimet e parashtruara në ankesë dhe nga vendimi i kundërshtuar objekt shqyrtimi i ankesës gjykata gjen se AL gabimisht ka refuzuar kërkesën për kompensim të pagave të papaguara në shumën e njohur nga Gjykata Komunale në Vushtrri dhe të lejuar për përmbarrim sipas Aktvendimit E. nr. 820/06 datë 05 tetor 2006, pasi borxhi eventual për qira të pa paguar të dyqanit “Zenica” aset i NSH “Çyçavica” që ankuesi mund të ketë mbetur pa e paguar, nuk mund të

aplikohet në një kërkesë tjetër kreditore (siç është ky rast) pra të shqyrtuar në procedurë të likuidimit nga AL. Në një rast të tillë kompensimi eventual i kërkesave do të ishte i mundur vetëm me marrëveshje në mes të palëve. Në mungesë të një marrëveshje mes palëve, një kompensim i tillë i kërkesave, nuk është i mundur.

Prandaj, gjykata konstaton se përdorimi i të dhënave nga arkivi i NSH “Çyçavica” në dëm të një kërkesë kreditore të ankuesit në një procedurë të veçantë likuidimi për shqyrtim të kërkesave kreditore të të gjithë kreditorëve potencialë ndaj NSH-së, është i gabuar pasi kjo kërkesë veç është e miratuar me vendim të plotfuqishëm të gjykatës, andaj do të duhej një procedurë e veçantë për tu shqyrtuar pretendimet e NSH-së për qira të papaguar nda ankuesit. Prandaj, një kompensim i tillë i kërkesave nga AL është pothuajse arbitrar dhe si i tillë nuk është i mundur.

Gjykata e aprovon shumën në lartësi prej 625.50 € në emër të interesit ligjor bazuar në nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Sipas nenit të lartcekur të gjitha kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kusht që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

### **Taksat gjyqësore**

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta.

### **Këshilla juridike**

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrahet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Sylejman Shumolli  
Gjyqtar